

20131884652

**LIGJ PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË LIGJIT HUAMARRJE TË REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË TE BANKA PËR ZHVILLIM E KËSHILLIT TË EVROPËS SIPAS  
MARRËVESHJES KORNIZË PËR HUA PËR FINANCIM TË PJESSHËM TË  
PROJEKTIT PËR BANIM TË GRUPEVE TË CENUESHME SOCIALE**

Neni 1

Në Ligjin për huamarrje të Republikës së Maqedonisë te Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës sipas Marrëveshjes kornizë për hua për financim të pjesshëm të Projektit për banim të grupeve të cenueshme sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 133/2009), neni 5 ndryshohet si vijon:

"Për pjesën e mjeteve në shumë prej 17 603 000 euro do të lidhet Marrëveshje kornizë për nënhua për realizimin e Projektit për banim të grupeve të cenueshme sociale ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dhe SHA për Ndërtim dhe Ekonomizim me Hapësirë Banesore dhe me Hapësirë Afariste me Rëndësi për Republikën - Shkup.

Këto mjete Republika e Maqedonisë do t'i paguajë nga mjetet që do të grumbullohen me pagesë të mjeteve të huazuara nga SHA për Ndërtim dhe Ekonomizim me Hapësirë Banesore dhe me Hapësirë Afariste me Rëndësi për Republikën - Shkup.

Mjetet tjera në shumë prej 7 747 000 euro Republika e Maqedonisë do t'i paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë."

Neni 2

Neni 6 shlyhet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".